



Datë: 20.02.2026
Numër Protokolli: 952/2026

A.nr.32/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.32/2026, të datës 13.01.2026, të parashtruar nga ankuesi E.I, kundër organit të punësimit/Komuna Leposaviçit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.02.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.32/2026 e datës 13.01.2026 e parashtruar nga ankuesi E.I.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Leposaviqit që ankuesit E.I të lëshoj Akt Emërimit sipas konkursit me Referencë RN00017851 për pozitën “Asistent Administrativ”, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi, si dhe ti bëjë kompensimin e pagave nga data 13.11.2025.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, E.I (*tutje referuar ankuesja*), më datë 13.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ka nënshkruar akt emërimit me datë 13.11.2025 në pozitën Asistent Administrativ me organin punëdhënës respektivisht me Komunën e Leposaviqit, por kjo e fundit nuk e ka futë në listë të pagave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.01.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Leposaviqit, ndërsa, kjo e fundit më datë 28.01.2026, ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave tutje referuar Kolegji i Këshillit, **ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 58/2026 të datës 13.01.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër 2969 të datës 13.11.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 28.01.2026 dhe vendimi A.nr. 1535/2025 të KPMSHCK.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse;

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë se Komuna e Leposaviqit me datë 14.05.2025 ka shpallur konkursin me Referencë RN00017851, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i Mesëm, për pozitën e punës “Asistent Administrativ” numëri i kërkuar 3 me afat aplikimi nga data 15.05.2025 deri me datë 13.06.2025.

Lidhur me këtë konkurs një pjesëmarrëse në konkurs kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK me datë 05.08.2025, ndërsa KPMSHCK si organ eprorë në fushën e shërbimit civil kishte marrë vendim me datë 28.10.2025 me numër A.nr. 1535/2025 sipas të cilit vendim kishte refuzuar ankesën dhe kishte lënë në fuqi Njoftimin e datë 29.07.2025 të NJMBNJ të Komunës së Leposaviqit ku në mesin e kandidatëve fitues ka qenë edhe E.I.

Andaj nisur nga ajo që u tha më lartë lidhur me këtë procedurë të rekrutimit dhe pasi që është konstatuar se procedura është zhvilluar në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi, ankuesit i është lëshuar akt emërimi me datë 13.11.2025, por nuk është futur në listën e pagave, meqenëse marrëdhënia e punës në mes ankuesit dhe organit punëdhënës është krijuar me akt emërimit të datës së lartpërmendur dhe në dritë të thënieve më lartë, Kolegji ju referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht nenit 37 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se “ Marrëdhënia e punës në shërbimin civil 1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunës/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj”, prandaj në bazë të kësaj dispozite Komuna e Leposaviqit obligohet që ankuesin ta fusë në listën e pagave dhe ti bëjë kompensimin e pagave nga data 13.11.2025 deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi, sepse tashmë ekziston krijimi i marrëdhënies së punës dhe obligimi ligjor për kompensimin e ankuesit.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë dhe në harmoni me Ligjin Nr.06/L-148 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës respektivisht nenin 21 paragrafi 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se ” Vendimi i Këshillit 1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. 2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit. 3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës” ankuesi duhet të sistemohet në listën e pagave dhe të kompensohet sipas pikës II të dispozitivit.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA.A.Nr.32/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Leposaviqit
- Ankuesit E.I; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.